

VENDIM
Nr. 70, datë 13.3.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN TIP,
MBI VERIFIKIMIN DHE VULOSJEN E MATËSVE ELEKTRIKË, TË PROPOZUARA
NGA SHOQËRIA OSSH SHA**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 77, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; ligjit nr. 126/2020 “Për metrologjinë”; “Kodit të Matjes”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 101, datë 26.8.2008; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.3.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 994/1 prot., datë 10.3.2023 të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi fillimin e procedurave për disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin e matësve të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 164/2016”,

konstatoi se:

- Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), me vendimin nr. 164, datë 6.10.2016, ka vendosur miratimin e kontratës tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë.

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., me shkresën nr. 2136 prot. datë 1.3.2023, protokolluar në ERE me nr. 994 prot., datë 3.3.2023, kërkon miratimin nga ERE të disa ndryshimeve në kontratën tip si më poshtë:

- Ndryshimi i afatit të vlefshmërisë së kontratës tip, siç referuar kapitullit XXVI, pika 26.1, duke vlerësuar vendosjen e një afati të ri, i cili do të mund të ndjekë më mirë dinamikën e zhvillimit të sistemit elektroenergjetik në tërësi dhe atë të sistemit të matjes në veçanti. Sistemi i matjes së energjisë elektrike zë një rol të veçantë edhe në dinamikën e hapjes dhe liberalizimit të tregut të energjisë elektrike në vendin tonë.

- OSSH sh.a., në opinionin e saj, e sheh me vlerë liberalizimin e mëtejshëm të dhënies së autorizimeve, për verifikim të instrumenteve matës ligjërish të kontrolluara, matës të energjisë elektrike edhe për subjekte të tjera, me qëllim rritjen e rezultatit, shpejtësinë e proceseve dhe shkurtimin e afateve të testimit periodik apo dhe gjithë proceseve të tjera që do të kryhen nga OSSH sh.a., në bashkëpunim me subjektet e autorizuar nga DPM-ja, siç autorizuar nga legjislacioni në fuqi.

- Ndryshimin e kapitullit XXI, pika 21.1, i cili shprehet “...plani i përgatitur dhe i miratuar nga DPM, në bashkëpunim me operatorin dhe subjektin e autorizuar”, duke sqaruar se plani i testimit periodik të matësve është një proces tërësisht i shoqërisë OSSH sh.a. dhe si i tillë, nuk mund të diktohet nga asnjë institucion tjetër (plani vjetor i testeve), pra do të ishte me vend që roli i DPM-së në këtë proces të reduktohej vetëm në kontrollin e periudhave të testimit të matësve, sipas Kodit të Matjes.

- Në lidhje me ndryshimin e afatit të vlefshmërisë së kontratës tip, sikurse referuar në kapitullin XXVI, pikën 26.1, vlerësohet që afati i vlefshmërisë së kontratës të ulet. Nga ERE vlerësohet një afat vlefshmërie jo më pak se 1 (një) vit dhe jo më shumë se 3 (tre) vjet dhe afati i kontratës të konsultohet edhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) dhe MIE-n.

- Për sa i përket ndryshimit të pikës 21.1 të kapitullit XXI, vlerësohet që në kontratë, kur trajtohet testimi periodik të përcaktohet se ky testim do të kryhet në përputhje me nenin 22, pika 6 e ligjit nr. 126/2020 “Për metrologjinë”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin dhe vulosjen e matësave elektrikë, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 164/2016, si më poshtë:

“Në kapitullin XXVI, pika 26.1, afati i vlefshmërisë së kontratës të ulet, në një afat vlefshmërie jo më pak se 1 (një) vit dhe jo më shumë se 3 (tre) vjet.”.

“Në pikën 21.1 të kapitullit XXI, në kontratë, kur trajtohet testimi periodik të përcaktohet se ky testim do të kryhet në përputhje me nenin 22, pika 6 e ligjit nr. 126/2020 “Për metrologjinë”.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti